

HISTORIKU I SHKOLLËS SH. F. M. U “7 MARS” POTUROC

Sikur se shumë shkolla të tjera edhe shkolla jonë ka një histori dhe një rrugëtim, me sfida e vështërsi deri në ditët e sotme.

Themelet e shkollës tonë filluan mu në vitin 1976 ku banorët e këtij fshati duke parë rëndësin dhe nevojën e shkollimit murren iniciativën për ndërtimin e një shkolle. Nxënësit e fshatit mësimet i vijuan nga kl. I-IV në Dobrajë të Madhe me 4 km, ndërsa nxënësit nga kl. V-VIII në Magurë që udhëtonin deri në 8 km në ditë. Me iniciativën e banorëve dhe udhëheqësisë së fshatit në krye me Ruzhdi Shabanin, dhe kontributin e banorëve të fshatit që kontribuan materialisht me baza vullnetare dhe me punë fizike u inicua ndërtimi i shkollës së fshatit.

Në muajin prill vitit 1976 –ës filloj ndërtimi i shkollës me dy dhoma mësimi, gjithashtu për punët të tjera të merimetimit dhe pajisjes së shkollës me inventar ka ndihmuar edhe komuna e Lipjanit.

Shkolla ka filluar punën me 01.09.1977-1978 me katër paralele nga kl. I-IV atë kohë kanë punuar 4 mësues dhe një puntor teknik, si paralele e ndarë e SH.f “Stanko Buriq” në Magurë , me gjithësej 92 nxënës të fshatrave Poturoc dhe Torinë. Mësuesit e parë kanë qenë Dinore Brestovci, Muharrem Brestovci, Fazli Maloku dhe Adem Bytyqi, kurse si puntorë teknik Selim Shabani.

Në vitin 1981 shkolla ka qenë paralele e ndarë e SH. F. M. U “Hyvzi Sylejmani” në Dobrajë të Madhe. Në fillim të vitit 2001 si donacion i shtetit të Danimarkës nëpërmes shoqatës ADRA u ndërtua objekti i shkollës së re në lokacionin e njejët megjithësejt 37 m² dhe S= 73 ari. Që nga viti 2002-2003 në shkollë vijnë mësimet nxënësit nga parafillorët deri në kl.IX- të. Atëherë numronin 270nx. Dhe funksiononte ende si paralele e ndarë e SH. F. M. U “Hyvzi Sylejmani “.

Në majë të vitit 2010 nga DKA Lipjanë e cila është paraqitur në MASHT dhe u inicua procedura e pavarësimit të shkollës nga shkolla amë, kurse në shtator të vitit 2010, shkolla u pavarësua pasi që i plotësoi të gjitha kushtet. Venedimi u murr nga ministria e atëhershme e arsimit e z. Enver Hoxha me 14.06.2010 në atë kohë drejtor i shkollës u zgjodhë Ejup Banushi. Shkolla atëhere numëronte 320 nx. dhe funksiononte me 11 paralele, numri i nxënësve vazhdonte të rritej dhe në mungesë të hapsirës ishte e domosdoshëm ndërtimi i shkollës së re, e cila filloj të ndërtohet me 10.08.2010 me 470m².

Në mledhjen e mbajtur me 26.01.2011 u propozua emërtimi i shkollës dhe këshilli i shkollës me bashkëpunim me mësime dhënsit, prindërit dhe nxënësit, vendosen që të paraqesin në DKA- Lipjan, propozimin për emërtimin e shkollës, ata propozuan që shkolla të emërtohet “7 MARS” që lidhet me hapjen e shkollës së parë shqipe. Ky propozim u përkrah edhe nga MASHT i cili me vendimin e marrë me 08.12.2011 me nr.462 10B emërtoj shkollën me emrin “7 Marsi”.

Mësime dhënsit që punuan në këtë shkollë gjithmonë kishin një qëllim të përbashkët, dhe shkolla jonë tani radhitet me shkollat e tjera të mira të rajonit të komunës së Lipjanit për realizimin e procesit edukativo- arsimor.